



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

VENDIM

K.P.P. 689/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 01.11.2019, shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së për skualifikimin e ofertës të operatorit ekonomik “Erisoni Company” sh.p.k., në procedurën e prokurimit, “*Procedurë e hapur*”, me nr. REF-30816-07-18-2019, me objekt: “*Blerje artikuj tonera për printera dhe fotokopje*”, me fond limit 4,327,091.6 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 19.08.2019, nga autoriteti kontraktor, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së për skualifikimin e ofertës të operatorit ekonomik “Infosoft Office” sh.p.k., në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Ankimues:

Operatori ekonomik “Erisoni Company” sh.p.k.
Adresa: Lagjia nr.6, Rr. “Bashkimi”, Durrës.

Operatori ekonomik “Infosoft Office” sh.p.k.
Adresa: Autostrada Tiranë-Durrës, km 8, Kashar, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor
Adresa: Rr. “Sami Frashëri”, nr. 8, Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesve, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave dhe të dokumentacionit të dërguar nga ankimuesit dhe autoriteti kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se, mbështetur në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ankimuesit kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të. Gjithashtu, KPP konstatoi se këta të fundit kanë qenë pjesëmarrës në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.2. Ankimuesit kanë paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe, më pas, kanë paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

I.3. Ankimuesit kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektet e ankesave të ankimuesve.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 19.07.2019, në sistemin e prokurimeve elektronike është publikuar procedura e prokurimit, “*Procedurë e hapur*”, me nr. REF-30816-07-18-2019, me objekt: “*Blerje artikuj tonera për printera dhe fotokopje*”, me fond limit 4,327,091.6 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 19.08.2019, nga autoriteti kontraktor, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

II.2. Në datën 19.08.2019, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 30.08.2019, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

1. “Blueprint Technologies” sh.p.k	490,200.00 lekë, Skualifikuar;
2. “Adastra” sh.p.k.	687,000.00 lekë, Skualifikuar;
3. “Infosoft Office” sh.p.k.	808,270.04 lekë, Skualifikuar;
4. “Erisoni Company” sh.p.k.	1,257,730.00 lekë, Skualifikuar;
5. “IT Gjergji Kompjuter” sh.p.k.	2,691,905.66 lekë, Skualifikuar;
6. “Mond Office” sh.p.k.	2,799,540.00 lekë, Skualifikuar;
7. “Ervin Luzi” p.f.	3,245,682.00 lekë, Skualifikuar;
8. “Atom” sh.p.k.	3,949,500.00 lekë, Skualifikuar;

II.4. Me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorin ekonomik “Erisoni Company” sh.p.k. për skualifikimin e ofertës së tij, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, me arsyetimin si më poshtë vijon:

“monstra e paraqitur për artikullin nr.1 Toshiba E-Studio 207 është me part/number-in T-1640D, i cili nuk përputhet me part/number-in e kërkuar T-1640E (specifikisht nuk përputhet treguesi pas numrit, duhet E është D) përcaktuara në shtojcën 10, për fotokopje, artikulli nr.1. operatori nuk plotëson specifikimet teknike për çdo artikull siç janë përcaktuar në shtojcën 10 “Specifikimet teknike” të DT. Bazuar në shtojcën 9 (pika 2.3, gërma “b”) “Kapaciteti teknik” dhe shtojcën 10 “Specifikimet teknike” të DT mosplotësimi i specifikimeve për çdo artikull përbën kusht skualifikim”

II.4.1. Në datën 06.09.2019, operatori ekonomik “Erisoni Company” sh.p.k. ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e autoritetit kontraktor për skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, me argumentimin si më poshtë vijon:

“[...]Mostra e paraqitur per artikullin nr. 1 Toshiba-e Studio 207 eshte me part number T1640D. i cili nuk perputhet me part/numberin e kerkuar T-1640E(specifikisht nuk perputhet treguesi pas numrit, duhet E eshte D percaktuar ne shtojcen 10. Ne ju kemi paraqitur disa faqe ne internet qe tregojne qe toneri toshiba me part number T-1640D dhe toneri me part number T-1641E jane te njejta, jane kompatible me njera tjetren, ndryshon vetem vendi ku prodhohen. Bejne te njejtin numer kopjesh. Nuk kane asnje ndryshim. Shkronja mbrapa kodit nuk ndryshon asgje ne modelin e printerit thjesht vendin e prodhimit. Keto kode jane kompatibel me njera tjetren si edhe origjinale, kodet nuk ndryshojn as modelin e fotokopjes, as nr e kopjeve. Bashkangjitur faktet[...]”

II.4.2. Nga verifikimet e kryera në dokumentacionin e paraqitur pranë KPP, me anë të shkresës Nr. 4572/6 Prot. datë 13.09.2019, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimes “Erisoni Company” sh.p.k., duke mos e pranuar ankesën e paraqitur prej tij.

II.4.3. Në datën 17.09.2019, operatori ekonomik “Erisoni Company” sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt me ankesën e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

II.5. Me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorin ekonomik “Infosoft Office” sh.p.k. për skualifikimin e ofertës së tij, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, me arsyetimin si më poshtë vijon:

“mostrat e paraqitura nga operatori kane probleme me Pullën e sigurise se prodhuesit, Pulla e sigurise se prodhuesit nuk eshte sipas standarteve (minimalisht kjo pulle duhet te jete 3D dhe te percaktoje prodhuesin) kjo në kundërshtim me shtojcën 10 “Specifikimet teknike” ku përcakohet se “Tonerat/Bojërat duhet të mbajnë pullën e prodhuesit”. Mostra e paraqitur për artikullin nr.1 (fotokopje) Toshiba E-Studio 207 toneri ka part/numberin T-1640E9(5K) , i cili nuk përputhet me part/numberin e kërkuar T-1640E përcaktuara në shtojcën 10, për fotokopje, artikulli nr.1, kjo bie në kundërshtim me specifikimet teknike përcaktuar në shtojcën 10, konkretisht “Tonerat/Bojërat duhet të evidentohen nëpërmjet Part-Numberit përkatës, pasi është elementi kryesor dallues i përcaktuar në datashet-in dhe katalogun përkatës të llojit të të printerit apo fotokopjes për të cilën nevojitet” operatori nuk plotëson specifikimet teknike për çdo artikull siç janë përcaktuar në shtojcën 10 “Specifikimet teknike” të DT. Bazuar në shtojcën 9 (pika 2.3, gërma “b”) “Kapaciteti teknik” dhe shtojcën 10 “Specifikimet teknike” të DT mosplotësimi i specifikimeve për çdo artikull përbën kusht skualifikimi.”

II.5.1. Në datën 06.08.2019, operatori ekonomik “Infosoft Office” sh.p.k., ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e autoritetit kontraktor për skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, me argumentimin si më poshtë vijon:

“Nuk ekziston asnje standart kombëtar apo nderkombëtar për pullat e sigurisë së tonerave. Mund të ketë prodhues që elementet e sigurisë i vendosin në 3D, ka të tjerë që elementet e sigurisë i realizojnë edhe në një dimension (1D). Duke qenë se 3D presupozon që pulla të ketë tre dimensione, në asnjë rast nuk njihim ndonjë prodhues që pullën ta ketë 3D, duke filluar qoftë nga prodhuesi Lexmark, Xerox etj. Pullat e sigurisë kanë të stampuar markën e prodhuesit, një shkelqim dhe refleks i cili ndryshon në varesi të dritës, gjë që e plotësojnë edhe pullat e tonerave të paraqitura nga ana jone. As në DST ju nuk kishit përcaktuar ndonjë standart për pullën e sigurisë. Kërkesa juaj për pullën e sigurisë ishte vetëm kështu: Tonerat/Bojërat duhet të përmbajnë pullën e sigurisë së prodhuesit. Përsa kohe ju nuk kishit venë asnjë specifikim të vecantë lidhur me pullën, nuk mundet që ta ngrini këtë pretendim tani. Nëse AK kishte të tilla kërkesa për pullën e sigurisë duhej të kishit përcaktuar ato në DST. Për sa kohe që AK nuk ka përcaktuar në DST asnjë specifikim teknik për pullat e sigurisë së prodhuesve, nuk ka sesi të na skualifikojë për mosplotësimin e specifikimeve që nuk i ka përcaktuar. Sipas nenit 23 të LPP, AK ka detyrimin të përcaktojë me saktësi specifikimet teknike në DST. Kërkesa juaj e vetme për pullat ishte “Tonerat/Bojërat duhet të përmbajnë pullën e sigurisë së prodhuesit” dhe në të kemi plotësuar me korrektesë këtë kërkesë, të gjithë tonerat kanë pullën e sigurisë së prodhuesit. Në shtojcën 9 dhe 10 janë dhënë specifikime teknike për tonerat, jo për pullat, dhe në të kemi plotësuar të gjitha specifikimet që keni përcaktuar për tonerat. Lidhur me pretendimin tuaj që pulla të përcaktojë prodhuesin, ju sqarojmë se tonerat e paraqitura nga kompania jone edhe në paketim edhe në pullën e sigurisë kanë të stampuar emrin tregëtar të prodhuesit (markën), duke përcaktuar kështu shumë qartë prodhuesin dhe duke qenë na siguruar që është pikërisht pulla e sigurisë së prodhuesit dhe jo një pulle tjetër, e vendosur nga kushdo. Në paketim keni të stampuar edhe adresën e faqes zyrtare të prodhuesit, ku mund të bëni verifikimet tuaja lidhur me prodhuesin. Kjo pulle ka të njëjtat standarde si pullat e prodhuesve origjinale OEM. Specifikimet teknike për tonerat të përcaktuara nga ju ishin:

-Tonerat/Bojërat duhet të evidentohen nëpërmjet Part-Numeri përkatës, pasi është elementi kryesor dallues i përcaktuar në datashet-in dhe katalogun përkatës të llojit të printerit apo fotokopjes për të cilën nevojitet.

-Tonerat/Bojërat për printera dhe fotokopje duhet të jenë origjinale ose kompatibël dhe nuk duhet të jenë të ricikluara apo të rimbushura.

-Tonerat/Bojërat duhet të përmbajnë pullën e sigurisë së prodhuesit.

-Për bojërat Likuide duhet të shprehet data e skadencës së tyre.

-Bojërat të kenë afat skadencë jo më pak se 1 vit nga momenti i lëvrimin të mallit

Mostrat e paraqitura nga ana jone plotësojnë të gjitha këto specifikime, duke përfshirë edhe ato të pulles së sigurisë. Në këto kushte, arsyeja për të cilën na keni skualifikuar nuk qëndron, dhe skualifikimi i ofenes sone është i pabazuar në ligj, pasi këto oferte ka plotësuar të gjitha kërkesat dhe specifikimet që ju kishit përcaktuar. Në bazë të nenit 46 dhe 53 të LPP, kërkojmë nxjerrjen e një klasifikimi të ri ku oferta jone të klasifikohet e rregullt, sepse kemi plotësuar të gjitha kërkesat e procedurës.”

II.5.2. Nga verifikimet e kryera në dokumentacionin e paraqitur pranë KPP, me anë të shkresës Nr. 4572/4 Prot. datë 13.09.2019, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues “Infosoft Office” sh.p.k., duke mos e pranuar ankesën e paraqitur prej tij.

II.5.3. Në datën 19.09.2019, operatori ekonomik ankimues “Infosoft Office” sh.p.k., ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

II.6. Në datën 02.10.2019, autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.5214prot. datë 01.10.2019, ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin e kërkuar në lidhje me procedurën e prokurimit të sipërcituar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, informacionit të autoritetit kontraktor dhe kërkesave të ankimuesve,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Erisoni Company” sh.p.k., mbi skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me arsyen: *[...]monstra e paraqitur për artikullin nr.1 Toshiba E-Studio 207 është me part/number-in T-1640D, i cili nuk përputhet me part/number-in e kërkuar T-1640E (specifikisht nuk përputhet treguesi pas numrit, duhet E është D) përcaktuara në shtojcën 10, për fotokopje, artikulli nr.1. operatori nuk plotëson specifikimet teknike për çdo artikull siç janë përcaktuar në shtojcën 10 “Specifikimet teknike” të DT. Bazuar në shtojcën 9 (pika 2.3, gërma “b”) “Kapaciteti teknik” dhe shtojcën 10 “Specifikimet teknike” të DT mosplotësimi i specifikimeve për çdo artikull përbën kusht skualifikim.[...]*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 9, pika 2.3.b “Kapaciteti teknik”, në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

“b) Për vlerësimin e ofertës teknike, Operatori ekonomik duhet të dorëzojë pranë Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në Autoritetin Kontraktor mostrat e produkteve që ato ofrojnë sipas listës së artikujve të kërkuar në këtë procedurë prokurimi ditën dhe orën e zhvillimit të tenderit të shoqëruar me autorizim dhe me procesverbalin e dorëzimit të artikujve. Mostrat do të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe do të jenë në kontroll të autoritetit kontraktor. Ato i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditë nga nënshkrimi të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit.

Ky do të jetë një kusht për skualifikim në rast se nuk do të paraqiten mostrat brenda afatit të përcaktuar, do të ketë mangësi në produktet e dorëzuara ose nuk do ketë përputhje me specifikimet teknike të kërkuara.”

III.1.2. Në shtojcën 10, “Specifikimet Teknike”, në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

“•Specifikimet teknike për Tonerat dhe Bojërat e printerave dhe fotokopjeve sipas tabelave si”

I	Artikujt/Printerat	Tonerat	Njesia	Sasite per Prokurim
1	Lexmark E240	Toner 24016SE	cope	45
2	OKI B430	Toner 43979201	cope	9
3	Xerox Phaser 3025	Toner 106R02773	cope	12
4	Laser Jet Pro 400	CE505X/CF280X	cope	185
5	Laser Jet Pro 3015	Toner HT-CE255XBK	cope	12
6	Ricor Afico MP 301 SP	Toner MP301	cope	12

II	FOTOKOPJE	TONERA		
1	Toshiba E studio 207	Toner Toshiba T-1640E	cope	26
2	Fotokopje Xerox Ëorkcentre 5330	Toner 006R01159	cope	2
3	KYOCERA FS 6525 MFP	Tonera TK-475	cope	4

- Tonerat/Bojërat duhet të evidentohen nëpërmjet part/number-it përkatës siç janë në tabelen e mesiperme, pasi është elementi kryesor dallues i përcaktuar në datasheet-in dhe katalogun e printerit apo fotokopjes për të cilën nevojitet.
- Tonerat/Bojërat duhet të evidentohen nëpërmjet Part-Numberit përkatës, pasi është elementi kryesor dallues i përcaktuar në datashet-in dhe katalogun përkatës të llojit të printerit apo fotokopjes për të cilën nevojitet.
- Tonerat për printerat dhe fotokopjet duhet të jenë origjinale dhe nuk duhet të jenë tonera kompatibël të ricikluar apo të rimbushur.
- Tonerat/Bojërat duhet të mbajnë pullën "Genuine".
- Për bojërat Likuide duhet të shprehet data e skadencës së tyre.

Bojrat të kenë afat skadencë jo më pak se 1 vit nga momenti i lëvrimin të mallit

III.1.3.Me anë të shtojcës mbi modifikimin e dokumentave të tenderit, autoriteti kontraktor ka modifikuar kriterin e mësipër, si dhe specifikimet teknike, si më poshtë vijon:

"Ishte:

Pika 2.3. Kapaciteti Teknik, gërma c:

c)Deklaratë nga operatori ekonomik e cila të përmbajë që tonerat dhe bojërat përmbushin këto kritere:

- Tonerat/Bojërat duhet të evidentohen nëpërmjet Part-Numberit përkatës, pasi është elementi kryesor dallues i përcaktuar në datashet-in dhe katalogun përkatës të llojit të printerit apo fotokopjes për të cilën nevojitet.
- Tonerat/Bojrat për printera dhe fotokopje duhet të jenë origjinale nuk duhet të jenë kompatibël, të ricikluara apo të rimbushura.
- Tonerat/Bojërat duhet të përmbajnë pullën e sigurisë së prodhuesit "Genuine".

- Për bojërat Likuide duhet të shprehet data e skadencës së tyre.
- Bojrat të kenë afat skadencë jo më pak se 1 vit nga momenti i lëvrimin të mallit.

Bëhet:

c)Deklaratë nga operatori ekonomik e cila të përmbajë që tonerat dhe bojërat përmbushin këto kritere:

- Tonerat/Bojërat duhet të evidentohen nëpërmjet Part-Numberit përkatës, pasi është elementi kryesor dallues i përcaktuar në datashet-in dhe katalogun përkatës të llojit të printerit apo fotokopjes për të cilën nevojitet.
- Tonerat/Bojrat për printera dhe fotokopje duhet të jenë origjinale ose kompatibël dhe nuk duhet të jenë të ricikluara apo të rimbushura.
- Tonerat/Bojërat duhet të përmbajnë pullën e sigurisë së prodhuesit.
- Për bojërat Likuide duhet të shprehet data e skadencës së tyre.
- Bojrat të kenë afat skadencë jo më pak se 1 vit nga momenti i lëvrimin të mallit.

Ishte:

I	Artikujt/Printerat	Tonerat	Njesia	Sasite per Prokurim
				45
1	<i>Lexmark E240</i>	Toner 24016SE	<i>cope</i>	
2	<i>OKI B430</i>	Toner 43979201	<i>cope</i>	9
3	<i>Xerox Phaser 3025</i>	Toner 106R02773	<i>cope</i>	12
4	<i>Laser Jet Pro 400</i>	CE505X/CF280X	<i>cope</i>	185
5	<i>Laser Jet Pro 3015</i>	Toner HT-CE255XBK	<i>cope</i>	12
6	<i>Ricor Afico MP 301 SP</i>	Toner MP301	<i>cope</i>	12

II	FOTOKOPJE	TONERA		
1	<i>Toshiba E studio 207</i>	Toner Toshiba T-1640E	<i>cope</i>	26
2	<i>Fotokopje Xerox Eorkcentre 5330</i>	Toner 006R01159	<i>cope</i>	2
3	<i>KYOCERA FS 6525 MFP</i>	Tonera TK-475	<i>cope</i>	4

- Tonerat/Bojërat duhet të evidentohen nëpërmjet part/number-it përkatës siç janë ne tabelen e mesiperme, pasi është elementi kryesor dallues i përcaktuar në datasheet-in dhe katalogun e printerit apo fotokopjes për të cilën nevojitet.
- Tonerat/Bojërat duhet të evidentohen nëpërmjet Part-Numberit përkatës, pasi është elementi kryesor dallues i përcaktuar në datashet-in dhe katalogun përkatës të llojit të printerit apo fotokopjes për të cilën nevojitet.
- Tonerat për printerat dhe fotokopjet duhet të jenë origjinale dhe nuk duhet të jenë tonera kompatibël të ricikluar apo të rimbushur.

- Tonerat/Bojërat duhet të mbajnë pullën "Genuine".
- Për bojërat Likuide duhet të shprehet data e skadencës së tyre.
- Bojrat të kenë afat skadencë jo më pak se 1 vit nga momenti i lëvrimin të mallit

Bëhet

I	Artikujt/Printerat	Tonerat	Njesia	Sasite per Prokurim
				45
1	<i>Lexmark E240</i>	Toner 24016SE	<i>cope</i>	
2	<i>OKI B430</i>	Toner 43979201	<i>cope</i>	9
3	<i>Xerox Phaser 3025</i>	Toner 106R02773	<i>cope</i>	12
4	<i>Laser Jet Pro 400</i>	CF280X	<i>cope</i>	185
5	<i>Laser Jet Pro 3015</i>	Toner HP-CE255X	<i>cope</i>	12
6	<i>Ricor Afico MP 301 SP</i>	Toner MP301	<i>cope</i>	12

II	FOTOKOPJE	TONERA		
1	<i>Toshiba E studio 207</i>	Toner Toshiba T-1640E	<i>cope</i>	26
2	<i>Fotokopje Xerox Eëorkcentre 5330</i>	Toner 006R01159	<i>cope</i>	2
3	<i>KYOCERA FS 6525 MFP</i>	Tonera TK-475	<i>cope</i>	4

- Tonerat/Bojërat duhet të evidentohen nëpërmjet part/number-it përkatës siç janë në tabelen e mesiperme, pasi është elementi kryesor dallues i përcaktuar në datasheet-in dhe katalogun e printerit apo fotokopjes për të cilën nevojitet.
- Tonerat/Bojërat duhet të evidentohen nëpërmjet Part-Numberit përkatës, pasi është elementi kryesor dallues i përcaktuar në datashet-in dhe katalogun përkatës të llojit të të printerit apo fotokopjes për të cilën nevojitet.
- Tonerat për printerat dhe fotokopjet duhet të jenë origjinalë ose kompatibël dhe nuk duhet të jenë të ricikluar apo të rimbushur.
- Tonerat/Bojërat duhet të mbajnë pullën e prodhuesit.
- Për bojërat Likuide duhet të shprehet data e skadencës së tyre.
- Bojrat të kenë afat skadencë jo më pak se 1 vit nga momenti i lëvrimin të mallit

III.1.4.Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: "Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese." Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: "Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit." "

III.1.5.Në nenin 27 pika 6 gërma “a” të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se: *“Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a)mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit kontraktor. Ato i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, 30 (tridhjetë) ditë pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimitdhe/ose “*

III.1.6.Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 2 i ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik”*, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës barazisë, dhe mosdiskriminimit janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato.

III.1.7.Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor dhe operatori ekonomik ankimues “Erisoni Company” sh.p.k., rezulton se ky i fundit, në përmbushje të kriterit të mësipërm të kualifikimit, për fotokopjen *Toshiba E Studio 207*, ka paraqitur toner me numër pjese (part number) T-1640D, ndërkohë që në specifikimet teknike autoriteti kontraktor ka përcaktuar se toneri për fotokopjen e mësipërme duhet me numër pjese T-1640E. Nga verifikimi i specifikimeve teknike të tonerave T-1640D dhe T-1640E, si dhe nga krahasimi i tyre, rezulton se të dy tonerat janë kompatibël për fotokopjen *Toshiba E Studio 207* dhe kanë kapacitete teknike të njëjta lidhur me numrin maksimal të kopjeve, ngjyra etj. Në këto kushte, Komisioni gjykon se, toneri i ofruar nga ankimuesi është kompatibël dhe ekuivalent me tonerin e kërkuar nga autoriteti kontraktor, në përputhje edhe me kriterin e ndryshuar nga autoriteti kontraktor *“Tonerat për printerat dhe fotokopjet duhet të jenë origjinalë ose kompatibël dhe nuk duhet të jenë të ricikluar apo të rimbushur”*. Komisioni thekson se, kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës dhe rrjedhimisht ky i fundit do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Erisoni Company” sh.p.k. qëndron.

III.2. Referuar informacionit të siguruar nga Komisioni i Prokurimit Publik, nëpërmjet verifikimit në sistemin e prokurimeve elektronike (SPE) si dhe informacionit të sjellë nga autoriteti kontraktor mbi procedurën e prokurimit *“Procedurë e hapur”*, me nr. REF-30816-07-18-2019, me objekt:

“Blerje artikuj tonera për printera dhe fotokopje”, me fond limit 4,327,091.6 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 19.08.2019, nga autoriteti kontraktor, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, rezulton se Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në datën 30.08.2019 ka kryer klasifikimin e ofertave, duke skualifikuar operatorin ekonomik “Infosoft Office” sh.p.k. për dy arsye të cilat i janë bërë të njohura ankimuesit, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike në këtë datë dhe konkretisht:

“1.mostrat e paraqitura nga operatori kane probleme me Pullën e sigurise se prodhuesit, Pulla e sigurise se prodhuesit nuk eshte sipas standarteve (minimalisht kjo pulle duhet te jete 3D dhe te percaktoje prodhuesin) kjo në kundërshtim me shtojcën 10 “Specifikimet teknike” ku përcakohet se “Tonerat/Bojërat duhet të mbajnë pullën e prodhuesit”.

2.Mostra e paraqitur për artikullin nr.1 (fotokopje) Toshiba E-Studio 207 toneri ka part/numberin T-1640E9(5K) , i cili nuk perputhet me part/numberin e kërkuar T-1640E përcaktuara në shtojcën 10, për fotokopje, artikulli nr.1, kjo bie në kundërshtim me specifikimet teknike përcaktuar në shtojcën 10, konkretisht “Tonerat/Bojërat duhet të evidentohen nëpërmjet Part-Numberit përkatës, pasi është elementi kryesor dallues i përcaktuar në datashet-in dhe katalogun përkatës të llojit të të printerit apo fotokopjes për të cilën nevojitet” operatori nuk plotëson specifikimet teknike për çdo artikull siç janë përcaktuar në shtojcën 10 “Specifikimet teknike” të DT. Bazuar në shtojcën 9 (pika 2.3, gërma “b”) “Kapaciteti teknik” dhe shtojcën 10 “Specifikimet teknike” të DT mosplotësimi i specifikimeve për çdo artikull përbën kusht skualifikimi.”

III.2.1.Nga shqyrtimi i informacionit dhe dokumentacionit të depozituar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit, si dhe nga shqyrtimi i ankesave të paraqitura nga operatori ekonomik ankimues respektivisht pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik, rezulton se ankimuesi nuk e ka ankimuar arsyen e skualifikimit të ofertës së tij ekonomike “[...]2.Mostra e paraqitur për artikullin nr.1 (fotokopje) Toshiba E-Studio 207 toneri ka part/numberin T-1640E9(5K) , i cili nuk perputhet me part/numberin e kërkuar T-1640E përcaktuara në shtojcën 10, për fotokopje, artikulli nr.1, kjo bie në kundërshtim me specifikimet teknike përcaktuar në shtojcën 10, konkretisht “Tonerat/Bojërat duhet të evidentohen nëpërmjet Part-Numberit përkatës, pasi është elementi kryesor dallues i përcaktuar në datashet-in dhe katalogun përkatës të llojit të të printerit apo fotokopjes për të cilën nevojitet” [...]”. Në ankesat e paraqitura pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, ankimuesi ka kundërshtuar vetëm arsyen e skualifikimit në lidhje me pullën e sigurisë të prodhuesit, e cila nuk është pranuar nga autoriteti kontraktor.

III.2.2. Operatori ekonomik ankimues është njohur në sistemin e prokurimeve elektronike me arsyet dhe shkaqet e skualifikimit, për të cilat i lind e drejta të ankimohe sipas shkallëve të ankimit fillimisht pranë autoritetit kontraktor dhe më pas në Komisionin e Prokurimit Publik. Për sa më sipër, rezulton se operatori ekonomik ankimues “Infosoft Office” sh.p.k. nuk i ka ankimuar të gjitha arsyet e skualifikimit pranë autoritetit kontraktor dhe më pas pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke mos respektuar shkallët e ankimit, në përputhje me nenin 63, pika 2 dhe pika 6 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në të cilin parashikohet se: “2. Ankesa kundër vendimeve të autoritetit kontraktor i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkëljen e pretenduar, sipas këtij ligji”. “6. Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimuesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është

njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim e ankesës i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor.”

III.2.3. Komisioni i Prokurimit Publik arsyeton se, operatori ekonomik ankimues nuk ka respektuar procedurën e ankimimit bazuar në legjislacionin për prokurimin publik fillimisht në autoritetin kontraktor dhe më pas pranë organit më të lartë në fushën e prokurimeve. Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se edhe në hipotezën se pretendimet e paraqitura nga operatori ekonomik “Infosoft Office” sh.p.k., pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik do të qëndronin, operatori ekonomik ankimues nuk do të ndryshonte gjendjen e tij faktike e juridike, por do të mbetej sërish i skualifikuar nga procedura në fjalë, për arsyen e skualifikimit, të cilën nuk e ka ankimuar në ankesat e paraqitura prej tij, në respekt të shkallëve të ankimimit. Rrjedhimisht, ankesa e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues nuk mund të merret në shqyrtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Erisoni Company” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me nr. REF-30816-07-18-2019, me objekt: “*Blerje artikuj tonera për printera dhe fotokopje*”, me fond limit 4,327,091.6 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 19.08.2019, nga autoriteti kontraktor, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.
2. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Infosoft Office” sh.p.k., për procedurën e prokurimit të sipërcituar.
3. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për skualifikimin e operatorit ekonomik “Erisoni Company” sh.p.k dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e kualifikuar këtë operator ekonomik.
4. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi, duke dokumentuar veprimet e kryera.
5. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifave financiare të paguara nga operatori ekonomik “Erisoni Company” sh.p.k.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1502 protokoli Datë 17.09.2019; Nr. 1510 protokoli Datë 19.09.2019;

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha